



COVID-19

DHE UDHËTIMI



Kam rezultuar pozitiv për COVID-19. Kur mund të udhëtoj?

Nëse keni simptoma të COVID-19, duhet të veçoheni në mënyrë të sigurt në shtëpi apo në një hotel për të paktën 10 ditë pasi t'ju jenë shfaqur simptomat. Simptomat e COVID-19 përfshijnë temperaturë, ethe, kollë, marrje fryme, vështirësi në frymëmarrje, këputje, dhimbje muskulore ose të trupit, dhimbje koke, humbje të re të shijes apo nuhatjes, dhimbje fyti, hundë të zëna, rrufë, të përziera, të vjella ose diarre. **Duhet t'i anuloni të gjitha udhëtimet që mund të keni planifikuar gjatë kësaj kohe.** Mund të udhëtoni pas 10 ditëve nëse nuk keni pasur temperaturë gjatë 24 orëve të fundit (pa marrë mjekime për uljen e temperaturës) dhe nëse ju janë përmirësuar simptomat.

Nëse nuk keni simptoma të COVID-19, duhet të veçoheni në mënyrë të sigurt në shtëpi apo në një hotel për të paktën 10 ditë pasi të keni rezultuar pozitiv në testin për COVID-19. **Duhet t'i anuloni të gjitha udhëtimet që mund të keni planifikuar gjatë kësaj kohe.** Nëse zhvillonit simptoma të COVID-19 gjatë këtyre 10 ditëve, ndiqni udhëzimet për njerëzit që kanë simptoma.

A mund të udhëtoj më herët nëse testohem përsëri dhe dal me rezultat negativ?

Jo. Një rezultat negativ në një test të dytë nuk ndryshon kohën kur do të mund të udhëtoni. Duhet të veçoheni në mënyrë të sigurt në shtëpi ose në një hotel për të paktën 10 ditë pasi të keni rezultuar pozitiv në testin për COVID-19. Nëse keni simptoma, duhet të qëndroni në shtëpi ose në një hotel për të paktën 10 ditë pas shfaqjes së simptomës suaj të parë.

Kam rezultuar negativ në testin për COVID-19 por jam duke udhëtuar me dikë që ka rezultuar pozitiv. A mund të udhëtoj gjithsesi?

Jo, nuk mund të udhëtoni dhe duhet t'i shtyni planet e udhëtimit me të paktën 11 ditë.

Nëse keni kaluar 10 minuta ose më shumë brenda dy metrave nga dikush që ka rezultuar pozitiv në testin për COVID-19, jeni në rrezik për të zhvilluar COVID-19. Për të mbrojtur personat rreth jush, duhet të veçoheni në mënyrë të sigurt në shtëpi ose në një hotel për 10 ditë pasi të keni pasur kontakt të ngushtë me partnerin tuaj të udhëtimit.

Si mund të gjej një dhomë hoteli falas që të veçohem në mënyrë të sigurt?

NYC Test & Trace Corps ofron dhoma hoteli falas për njerëzit që duhet të veçohen në mënyrë të sigurt në qytetin e Nju-Jorkut, duke përfshirë vizitorët. Për më shumë informacion, telefononi në nr. 212-COVID19 (212-268-4319).

Unë nuk kam sigurim shëndetësor apo ofrues të kujdesit shëndetësor në qytetin e Nju-Jorkut. Si mund të marr ndihmë mjekësore?

Mund të telefononi në nr. 844-NYC-4NYC (844-692-4692) për të biseduar me një ofrues të kujdesit shëndetësor, pavarësisht statusit tuaj të imigrimit apo mundësisë për të paguar.


Për më shumë, vizitoni [testandtrace.nyc](https://testandtrace.nyc.gov) ose telefononi në nr. **212-COVID19**.

**NYC
HEALTH +
HOSPITALS**



ÇFARË MUND TË BËNI PËR TË LUFTUAR COVID-19

TESTIM




Informohuni për statusin tuaj. Përfitoni një test për COVID-19 pa asnjë kosto për ju.

GJURMIM



Përgjigjuni telefonatës nga gjurmuesit tanë të kontaktit për të ndihmuar në ndalimin e përhapjes së COVID-19 në komunitetin tuaj.

KUJDES PËR VETEN



Izolohuni në mënyrë të sigurt për të mbrojtur të tjerët dhe kujdesuni për veten në një hotel ose në shtëpi.

NYC Test & Trace Corps është i përkushtuar në mbrojtjen e privatësisë dhe sigurisë së të dhënave tuaja personale dhe shëndetësore. Çdo informacion që marrim është konfidencial dhe i mbrojtur në përputhje me Kodin Shëndetësor të Qytetit të Nju-Jorkut. Test & Trace Corps nuk bën pyetje rreth statusit të emigrantit të askujt.

NYC
HEALTH+
HOSPITALS

Test & Trace
Corps